



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Drejtoria për Zhvillimit Rural

THIRRJE PËR APLIKIM PËR PJESËMARRJE NË TREGUN MOBIL

Ftohen të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për pjesëmarrje në tregun mobil në Komunën e Prishtinës për ekspozim të produkteve artizanale.

Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët/aplikantët:

1. Përparësi do të kenë aplikuesit nga Komuna e Prishtinës;
2. Aplikuesit që të vetmin burim të të ardhurave e kanë shitjen e artizanateve;
3. Në kushte të barabarta gratë dhe grupet e marginalizuara do të kenë përparësi;
4. Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
5. Nuk mund të jetë përfitues aplikuesi, nëse ndonjë anëtar i bashkësisë familjare është në shfrytëzim të ambienteve apo objekteve të Komunës me qëllim shitje apo ekspozimi të artizanaleve;
6. Përfituesit nuk kanë të drejtë ekspozimi të produkteve përveç artizanaleve.
7. Përparësi kanë fermerët që kanë qenë të rregullt në vitin e kaluar.

Dokumentacioni i kërkuar:

1. Kopja e një dokumenti identifikues të Republikës së Kosovës;
2. Dëshmi lidhur me vendbanimin - fatura e ujit, rrymës;
3. Deklarata nën betim.

VËREJTJE

Nëse komisioni parasheh të nevojshme të kërkoj dokumente shtesë të cilat mundësojnë përzgjedhjen e përfituesve. Aplikantët (fermerët) janë të obliguar t'i sjellin brenda afatit, në të kundërtën humbin të drejtën për të qenë përfitues.

Aplikimi bëhet nga 13/05/2025 deri 20/05/2025, në sportele, në objektin e komunës së vjetër.